



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.401/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Arsim Hamzaj - kryesues, Ramush Bardiqi dhe Hidajete Gashi Alaj - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Amine Demiri, kandidate për kuvend komunal në Komunën e Fushë Kosovës, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), të paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 01/3093-2025 të datës 03.11.2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Kuvendet Komunale, të mbajtura në 12 Tetor 2025, me datë 07.11.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET E PABAZUAR ankesa ZL.Anr.401/2025, e datës 05.11.2025, e parashtruar nga Amine Demiri kandidate për kuvend komunal në Komunën e Fushë Kosovës, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), të paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 01/3093-2025 të datës 03.11.2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Kuvendet Komunale, të mbajtura në 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

PZAP-i më datë 05.11.2025, ka pranuar ankesën ZL.Anr.401/2025, nga Amine Demiri, kandidate për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Fushë Kosovës, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në të cilën pretendon se ka dyshime lidhur me procesin e numërimit të votave për kandidatët për Kuvendin Komunal në QKN përkatësisht në klasën e votimeve në Sllatinë të Epërme me kodin 0905/01 në Komunë të Fushë Kosovës, i mungojnë 5 vota të cilat nuk janë pasqyruar në formular dhe sistem elektronik të KQZ-së. Tutje, parashtruesja e ankesës thekson se në këtë vendvotim rezulton se ka marrë vetëm 1 votë. Andaj, duke pasur parasysh këto rrethana dhe ngarkesa parashtruesja e ankesës konsideron se mund të ketë ndodhur ndonjë gabim gjatë numërimit dhe kërkon nga PZAP të urdhëroj KQZ-në të bëj rinumërimin e votave në këtë qendër votimi.

Në ankesë, parashtruesja e ankesës ka bashkangjitur disa dëshmitar dhe numrat personal të tyre që sipas saj mund të vërtetojnë dyshimet e saj.

Në përgjigje në ankesë të KQZ-së, theksohet se bazuar në nenin 101 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), Rregulloren Zgjedhore Nr.16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), Procedura e Veprimit në Qendrën Komunale të Numërimit për Zgjedhjet Lokale 2025, e miratuar më 01.10.2025, Nr.01/2601/2025, përcaktohet procedura e detajuar lidhur me procesin e numërimit në QKN. Rezultatet preliminare nga vendvotimet mund korrigjohen në Qendrën Komunale të Numërimit, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 14 të Rregullores Zgjedhore Nr.16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit (QKN). KQZ, njofton se procesi i numërimit të votave në QNR është zhvilluar në përputhje me Rregulloren Zgjedhore nr.14/2024, QNR ku ekipet e numërimit kanë bërë numërimin e votave të kandidatëve në transparencë të plotë, ku fletëvotimi është prezantuar në ekran dhe është parë nga vëzhguesit e akredituar.

Pala ankuese, ndër të tjera, ka pretenduar se disa persona kanë votuar për të mirëpo, sipas tij mungojnë votat e tyre. Ky pretendim nuk mund të vërtetohet, pasi që vota është e fshehtë dhe në përputhje me parimet e fshehtësisë dhe lirisë së votës dhe poashtu fletëvotimi nuk mund të identifikohet emri i votuesit

Në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP, gjatë shqyrtimit të ankesës është vërejtur se palët ankuese, nuk ka bashkëngjitur prova relevante, që do të mund të dëshmonin apo mbështesnin pretendimet e saj për mungesën e votave të pretenduar në vendvotimin e lartcekur.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimet ankimore, përgjigjeve në ankesë, konstaton se:

- Ankesa është e pabazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjeve në ankesë të paraqitur nga KQZ-ja, vlerësoj se pretendimet e kandidates për kuvend komunal të Komunës së Fushë Kosovës, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), Amine Demiri, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nuk është arritur që të vërtetohet se ka pasur parregullsi në qendrën e votimit të lartcekur, për faktin se nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, përkatësisht nuk ka afruar asnjë dëshmi lidhur me shkeljet e supozuara, edhe pse me kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin dhe në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave në qendrën e votimit të pretenduar të komunës së Fushë Kosovës.

Po ashtu edhe nga përgjigja e KQZ-së, vërehet se nuk qëndrojnë pretendimet e parashtruara me ankesë, sepse parashtrësia e ankesës nuk ka bashkëngjitur asnjë provë relevante që do mund të dëshmonin apo mbështesnin pretendimet e saj, për mungesën e votave të pretenduara në vendvotimin e lartcekur.

Bazuar në arsyet e sipërshënuara dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se *“PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin kriteret e miratuara paraprakisht”* dhe Neni 13 paragrafi 4 i Rregullores Nr.01/2025 për

Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: *"PZAP-i mund në përgjithësi të refuzoj një ankesë apo grup ankesash nëse ato nuk paraqesin raste prima facie ose ku ankesa apo grupi i ankesave është dukshëm i pabazë"*, lidhur me ankesën e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, Paneli vlerësoi se ankesa e parashtruar nga Amine Demiri kandidate për kuvend komunal nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) është e pabazuar pasi që nuk ka bashkangjitur asnjë provë përkatësisht pretendimi se duhet të ketë rinumërim të votave mbetet vetëm i natyrës deklarative dhe se nuk është mbështetur me asnjë provë që do të dëshmonte pretendimet ankimore. Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: *"Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse"*, Paneli vlerësoi se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesja e ankesës nuk ka arritur që të vërtetojë pretendimet e theksuara si më lartë, në rastin konkret të provuarit e asaj se duhet të ketë rinumërim, nuk është dëshmuar me prova nga pala ankuese, andaj në rrethanat e rastit konkret ankesa është refuzuar si e pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.401/2025, datë 07.11.2025

Kryesues i Panelit
Arsim Hamzaj



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.